



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr 41 prot.

Kamëz, më 5. 4. 2026

V E N D I M

Nr. 36 .Datë 23/4 2026

M B I

**“DHËNIE NDIHME EKONOMIKE PËR FAMILJET NË NEVOJË NGA BUXHETI I BASHKISË DHE NGA FONDI 6% I BLOK -NDIHMËS EKONOMIKE”**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 23.04.2026, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.26 Datë 17.04.2026 Në mbështetje të nenit 24, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit nr. 57, datë 18/07/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” neni 21, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.597 datë 04/09/2019 kreu 4 pika 3, për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 617 datë 22.09.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime” në VKM nr. 597 datë 04.09.2019, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 855 datë 29.12.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime” në VKM nr.597 datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, neni 4, neni 5, neni 6 të ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të Vendimit të Këshillit Bashkiak Kamëz nr. 90 dt. 17.12.2025 “Për Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 dhe Detajimin e Buxhetit të Bashkisë Kamëz për vitin 2025”; VKB nr.4 datë 26.01.2026 mbi “Miratimin e kriterëve për trajtimin me ndihmë ekonomike për familjet në nevojë nga buxheti i bashkisë” për vitin, 2026, **Këshilli Bashkiak Kamëz**;

V E N D O S I:

1. Miratimin e përdorimit e të ardhurave të bashkisë për ndihmë ekonomike për 270 familje me një fond prej 1,946,000 (Një milion e nëntëqind e dyzetë e gjashtë mijë) lekë për muajin Prill 2026. Fondi do të përballohet sipas strukturës buxhetore Gr 0, prog., 10430, Kap.5, Art 606.
2. Listën e muajit Mars 2026, prej 63 familje që janë rekomanduar nga administratorët shoqërorë për fondin 6% të bllok-ndihmës ekonomike. Fondi për këto familje është 374,456 (treqind e shtatëdhjetë e katërmijë e katërqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimit të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar.

KRYETAR KËSHILLI  
Hysen KOLDASHI

